



Dhjetë parimet e “shkencës me qytetarët”

“Shkenca me qytetarët” është një koncept fleksibël, që mund të adaptohet dhe aplikohet në kontekste të ndryshme dhe në disiplina të ndryshme shkencore. Formulimet e mëposhtme u zhvilluan nga grupi i punës ‘Ndarja e praktikave më të mira dhe ndërtimi i kapaciteteve’ në Shoqatë Europiane të Shkencës me Qytetarët, i drejtuar nga Muzeu i Historisë së Natyrës në Londër, me kontributin e shumë prej anëtarëve të Shoqatës. Kjo përpjekje rezultoi në disa prej parimeve kyçe, të cilat, si komunitet besojmë se theksojnë praktika të mira të shkencës me qytetarët.

- 1. Projektet e fokusuara në shkencën me qytetarët, i përfshijnë këta të fundit në mënyrë aktive në përpjekje, studime dhe kërkim shkencor, që gjenerojnë njohuri të reja apo kuptime të reja në lidhje me fenomene shkencore e që prekin shoqërinë. Qytetarët mund të jenë kontribuues në proces, të bashkëpunojnë, apo të udhëheqin, duke pasur gjithmonë një rol shumë aktiv në këto projekte.**
- 2. Projektet e fokusuara në shkencën me qytetarët kanë rezultate apo impakt shkencor.** Kjo ndodh për shembull përmes përgjigjes së një pyetjeje shkencore, informimit mbi një aktivitet konservimi, pjesëmarrjes në vendimmarrje, apo kontributit në hartimin e një politike mjedisore, etj.
- 3. Si shkencëtarët, ashtu dhe qytetarët e angazhuar në projektin shkencor përfitojnë nga pjesëmarrja në projekt.** Përfitimet mund të jenë nga më të ndryshmet, si për shembull: publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor, aksesit në procese të nxënies së njohurive të reja, kënaqësi në nivel personal, përfitime sociale, njohje e kontributit shkencor në rrjete kombëtare e ndërkombëtare, si dhe mundësi për të influencuar politika publike.
- 4. Qytetarët e përfshirë në projektin shkencor, nëse dëshirojnë, mund të angazhohen në të gjitha fazat e procesit shkencor.** Kjo përfshin aktivitete si: zhvillimi i pyetjes kërkimore, hartimi i metodave të kërkimit shkencor, mbledhja dhe analizimi i të dhënave, komunikimi i rezultateve dhe përdorimi i tyre në politikëbërje, etj.
- 5. Qytetarët e përfshirë në projektin shkencor marrin komente e sugjerime nga projekti.** Për shembull, ata informohen se si përdoren të dhënat e prodhuara prej tyre dhe cilat janë rezultatet shkencore dhe politike e shoqërore.
- 6. Shkenca me qytetarët konsiderohet një qasje shkencore, sikurse çdo formë tjetër e kërkimit shkencor, me kufizimet dhe anësitë e mundshme, të cilat duhet gjithmonë të konsiderohen e mbahen nën kontroll.** Megjithatë, ndryshe nga qasjet shkencore tradicionale, shkenca me qytetarët ofron mundësi për më shumë angazhim publik dhe demokratizim të shkencës.
- 7. Të dhënat dhe metadat e prodhuara në projektin shkencor të realizuar me qytetarët, janë të aksesueshme për të gjithë publikun, dhe kur është e mundur edhe botohen në burime e platforma të hapura.** Shkëmbimi i të dhënave mund të ndodhë përgjatë ose pas projektit, përveç atyre rasteve kur të dhënat mund të kompromentojnë çështje të sigurisë apo të privatësisë.

8. Qytetarët e përfshirë në projektin shkencor marrin kreditet përkatëse për rezultatet e projektit si dhe në publikimet përkatëse.
9. Programet e shkencës me qytetarë vlerësohen për produktin e tyre shkencor, cilësinë e të dhënave, eksperiencën e qytetarëve pjesëmarrës dhe impaktin e gjerë shoqëror dhe në politika.
10. Drejtuesit e projekteve të shkencës me qytetarë marrin në konsideratë edhe çështjet ligjore dhe etike që lidhen me pasurinë intelektuale, të drejtat e autorit, marrëveshjet në shkëmbimin e të dhënave, konfidencialitetin, njohjen e kontributit, dhe ndikimin mjedisor të aktiviteteve përkatëse.